



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE

METODOLOGJI PËR IDENTIFIKIMIN DHE KLASIFIKIMIN E INFRASTRUKTURAVE KRITIKE DHE INFRASTRUKTURAVE TË RËNDËSISHME TË INFORMACIONIT

Rrjetet e komunikimit janë një komponent i rëndësishëm i jetës së miliona qytetarëve Evropianë. Këto rrjete paraqesin strukturën e ardhshme të shoqërisë së informacionit dhe ofrojnë mjetet për një treg të vetëm dixhital. Disa pjesë të këtyre rrjeteve të komunikimit janë gjithashtu jetike për operacionet e Infrastrukturave Kritike, të cilat janë themelore për funksionimin e shoqërisë.

Çdo ditë, shumica e Infrastrukturave Kritike si, energjia elektrike dhe sistemet e transportit publik varen nga funksionimi korrekt i rrjeteve të komunikimit që mbështesin funksionimin e tyre. Këto sisteme dhe rrjete mbështetëse, të cilëve zakonisht iu referohemi si Infrastrukturë Kritike e Informacionit, përbëjnë shtyllat kryesore për funksionimin e ekonomisë dhe shoqërisë dhe një sulm ose ndërprerje ndaj këtyre aseteve dhe shërbimeve do ndikojë në një pjesë të madhe të popullsisë.

Në bazë të ligjit Nr. 2/2017 për “Sigurinë Kibernetike”, neni 6, pika 2, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, miraton listën e infrastrukturave kritike të informacionit dhe të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, e cila përditësohet të paktën një herë në dy vjet.

Sipas ligjit të mësipërm, neni 3, pika 5 dhe 6, “Infrastruktura e rëndësishme e informacionit përkufizohet si tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit të zotëruara nga një autoritet publik, i cili nuk është pjesë e infrastrukturës kritike të informacionit, por që mund të rrezikojë apo të kufizojë punën e administratës publike në rastin e cenimit të sigurisë së informacionit” dhe “Infrastruktura kritike e informacionit përkufizohet si është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në shëndetin, sigurinë dhe/ose mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe/ose funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe pse për shumë shtete përcaktimi i kriterëve është vendim politik, aplikimi i tyre përfshin çështje akademike, administrative dhe teknike. Për këtë arsye nevojitet një metodologji për përcaktimin e prioriteteve të mbrojtjes, duke i kategorizuar kriteret në dy grupe sipas **rëndësisë** dhe **riskut**, i cili është rezultat i kërcënimeve, vulnerabilitetit dhe pasojave.

Sipas ENISA, kriteret dhe faktorët për identifikimin dhe klasifikimin e infrastrukturave të informacionit mund të listohen si më poshtë:

Kriteret	Faktorët
Ndikimi Ekonomik	Efekti financiar
Ndikimi poliko/geveritar	Efekti në kohë
Ndikimi industrial/mjedisor	Shpërndarja gjeografike
Ndikimi shëndetësor	

Plani i punës deri në përcaktimin e listës së shërbimeve, operatorëve dhe sektorëve të CII-ve parashtrohet si më poshtë:

- 1) Përcaktimi i qëllimeve dhe politikave (E realizuar – Ligji për Sigurinë Kibernetike)
- 2) Identifikimi i operatorëve të CII
- 3) Përcaktimi i kriterëve të kritikalitetit
- 4) Identifikimi i infrastrukturave të informacionit
- 5) Identifikimi i shërbimeve, operatorëve dhe sektorëve të CII

Sektori	Nënsëktor	Shërbimet
1. Energjia	Elektriciteti	<ul style="list-style-type: none"> • I Përgjithshëm (all forms) • Transmetimi / Shpërndarja
2. Shëndetësia		
3. Financiar		<ul style="list-style-type: none"> • Bankar • Transaksione
4. Transporti	Transporti Ajror	
	Transporti Rrugor	
5. Industria		
6. Sektori qeveritar		
7. Mjedisi		

Faktorët që duhet të aplikohen për të identifikuar infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme janë:

- 1) Efekti financiar – ndikimi financiar që shkaktohet kur infrastruktura është jashtë funksionimit

- 2) Shpërndarja gjeografike – numri i individëve që mund të ndikohet nga mosfunksionimi i infrastrukturës
- 3) Efekti i kohës – përcaktohet në orë, ditë, muaj dhe vite, i cili tregon impaktin që një shërbim do ketë në humbje kur është jashtë funksionimit

Matrica për identifikimin e infrastrukturave të informacionit

Sektor	Energjitik	Shëndetësor	Financiar	Transporti	Industrial	Qeveritar	Mjedisi
Faktor							
Efekti Kohë							
Shpërndarja gjeografike							
Efekti Financiar							

Efekti i kohës

Rangu në orë	Më shumë se 60	48 deri 60	36 deri 48	24 deri 36	0 deri 24
--------------	----------------	------------	------------	------------	-----------

Shpërndarja gjeografike

Përqindja/numri i individëve të prekur

1. Më shumë se 58001
2. Midis 39001-58000
3. Midis 20001-39000
4. Midis 1001-20000
5. Deri në 1000

Efekti financiar

Më shumë se 3 300 000 - Kritik


Midis (3 300 000 ALL – 2 000 000) - I rëndësishëm

Sektori ku bën pjesë infrastruktura juaj:

- Energjistik
- Shëndetësor
- Financiar
- Transporti
- Industrial
- Sektori qeveritar
- Mjedisor

Emri i institucionit

Emri i sistemit




PO
(Të paktën 1 nga kriteret)

- Më shumë se 39000 individë ndikohen nga mosfunksionimi i infrastrukturës
- Shkëputja ndodh për intervale më të gjata se 24 orë
- Ndikimi financiar është më shumë se 3,3 mln lekë

JO


Sistemi/Rrjeti juaj nuk është kritik.
Ndiqni bllokskemën për të parë nëse Sistemi/Rrjeti është i rëndësishëm.

JO



PO

Sistemi/Rrjeti juaj është kritik.



- Numri i individëve të ndikuar nga mosfunksionimi është midis 2000-20 000
- Shkëputja ndodh për intervale nga 12-24 orë
- Ndikimi financiar është 2-3,3 mln lekë

PO

(Të paktë 1 nga kriteret)

Sistemi/Rrjeti juaj është i rëndësishëm.

JO

Sistemi/Rrjeti juaj nuk është as kritik as i rëndësishëm.